



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-41/1 të datës 03.01.2022, me pretendime për parregullsi në procedurat gjyqësore para Gjykatës themelore ///, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent sepse kërkesa përmban pretendime për të cilat KSHPK-ja tashmë ka vepruar në një rast me të njëjtin përshkrim faktik të pretendimeve si pretendimet në pyetje dhe ka vendosur në lidhje me të njëjtën - ka marre vendim të kompetencës së saj.

Lënda me numër 12-41/1 të datës 03.01.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 31 dhjetor 2021, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim me pretendime për parregullsi në procedurat gjyqësore në Gjykatën Themelore /// dhe është formuar lënda me numër 12-41/1 e datës 3 janar 2022.

Në denoncim, parashtruesi, pa iu referuar personave konkretë dhe veprimtarive të veçanta të paligjshme, paraqet pretendime të përgjithshme për parregullsi në proceset gjyqësore pranë Gjykatës themelore ///, si dhe parashtron pretendime për veprime korruptive në gjykatë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se nuk ka elemente për veprim kompetent, sepse denoncimi përmban pretendime për të cilat KSHPK-ja tashmë ka vepruar në një rast me të njëjtën fotografi të pretendimeve si pretendimet në fjalë dhe ka

vendosur sipas të njëjtave në seancën e 73-të të mbajtur më 18.08.2022 ka miratuar vendim nga kompetenca e saj (Vendimi numër 12-22/2, datë 22.08.2022, i publikuar në faqen e KSHPK-së).

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK -ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A:R:M

Miratoi: N.B

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska**

